

# 100 KLINIKA DHE SPITALE PRIVATE PJESË E RRJETIT MJEKËSOR TË SiCRED, I CILI ZGJEROHET TASHMË EDHE NË GREQI!

SiCRED e para në pagesat e dëmeve dhe përfitimeve për 4 mujorin tek Tregu i Sigurimit të Jetës, e cila me produktet e saj të sigurimit ofron mundësi investimi në Euro, USD dhe Lek, si një oportunitet i ri për financat personale të Shqiptarëve.

Shoqëria e Sigurimit të Jetës SiCRED sh.a. ndodhet pranë klientëve të saj që prej vitit 2003, me produktet e sigurimit të jetës me cilësore, të përshtatura për çdo nevojë dhe me shërbimin më të mirë mjekësor, të ofruar nga rrjeti mjekësor SiCRED. E ndërkohë SiCRED punon vazhdimisht për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe zgjeruar gamën e benefiteve që një klient përfiton duke qenë pjesë e saj.

Një ndër aspektet që SiCRED i kushton rëndësi të veçantë për të qenë sa më pranë klientit është zgjerimi i vazhdueshëm i rrjetit mjekësor ku të siguruarit për Jetën dhe Shëndetin tek SiCRED mund të përfitojnë shërbime të shumëllojshme mjekësore. Tashmë në këtë rrjet bëjnë pjesë klinika dhe spitale në pothuajse çdo qytet të Shqipërisë si dhe në shtete të Rajonit si Kosovë, Maqedoni e Turqi si dhe në Bashkimin Europian si Itali e Austri.

Së fundmi, pjesë e rrjetit mjekësor SiCRED, janë bërë edhe disa prej spitaleve më prestigjioze në Greqi, të cilat vijnë pranë çdo klienti të SiCRED me profesionalizmin, përkujdesjen dhe eksperiencën e tyre mbi 40 vjeçare.

Bashkëpunimi me spitalet më të mira të Greqisë, të cilët mbulojnë një diapazon të gjerë të shërbimeve mjekësore, duke filluar nga përkujdesjet mjekësore rutinë, e deri tek kardiologjia, njësia e veshkave artificiale, njësia e specialiteteve kirurgjikale, patologjike etj., është risia më e fundit e Shoqërisë së Sigurimit të Jetës SiCRED sh.a. Spitalet janë të pajisur me aparatet më moderne të teknologjisë bashkëkohore, të cilat rinovohen vazhdimisht në mënyrë që të jenë gjithmonë në një hap me zhvillimet e teknologjisë mjekësore, duke siguruar kështu një diagnostikim të shpejtë dhe të saktë për të gjitha problemet shëndetësore, për të gjitha kategoritë e pacientëve, fëmijë dhe të rritur.

SiCRED do të vijojë punën për zgjerimin e mëtejshëm të rrjetit mjekësor, duke e shtrirë rrjetin e saj jo vetëm në qytete të tjera të vendit tonë, por dhe jashtë Shqipërisë. Synimi është zgjerimi i specialiteteve mjekësore të ofruara, sjellja më pranë klientëve e eksperiencave të tjera diagnostikuese, duke u përpjekur të jemi pranë klientëve praktikisht për çdo nevojë shëndetësore.

Në përzgjedhjen e spitaleve dhe klinikave që i bashkohen rrjetit, në SiCRED i kushtohet një rëndësi e veçantë faktit që spitali apo klinika, jo vetëm të jetë e licencuar konform të gjitha kërkesave ligjore, por njëkohësisht të jetë e afirmuar për cilësinë e shërbimeve që ofron dhe të gëzojë një emër të mirë.



## Sigurimi i jetës dhe shëndetit nga SiCRED, një zgjidhje për të gjithë!

Për të përfituar shërbime dhe mbulim të shpenzimeve mjekësore pranë klinikave dhe spitaleve pjesë të rrjetit mjekësor, SiCRED sugjeron produktet e saj të sigurimit. Paketat e sigurimit të Jetës dhe Shëndetit Cash Plan, rekomandohen për këtë rast, sepse janë të përshtatura për nevojat dhe kërkesat e individëve dhe ofrohen me çmime shumë të favorshme. Me sigurimin privat të jetës dhe shëndetit, individit siguron shëndetin e tij duke patur një burim të ardhurash për mbulimin e shpenzimeve mjekësore, e njëkohësisht garanton për familjen e tij mbrojtje financiare në rast të humbjes së jetës.

Sigurimi Jetë dhe Shëndet Cash Plan ofron mundësinë për një kontroll më mirë të financave personale dhe të familjes. Nuk është më e nevojshme që të mbahen rezervë dhe të bllokua shuma parash për të garantuar siguri ndaj të papriturave jetësore dhe shëndetësore. Polica e sigurimit i përgjigjet më së miri të papriturave të tilla. Ajo ofron një zgjidhje të plotë për shëndetin, duke garantuar mbulim të shpenzimeve mjekësore për çdo shkak (kontrolle diagnostikuese, sëmundje, aksident, etj.), shpenzime për ndërhyrje kirurgjikale me shtrim dhe pa shtrim, vizita doktorit, ekzaminime mjekësore, ilaçe, etj.

Sigurimi gjithashtu ofron edhe një paketë të plotë me ekzaminime mjekësore të kujdesit parandalues.

Kështu, klientët e SiCRED kanë të drejtë të marrin shërbime mjekësore në të gjithë rrjetin mjekësor me të cilin SiCRED bashkëpunon në Shqipëri dhe jashtë vendit, tashmë me mbi 100 klinika dhe spitale private, duke përfituar trajtim preferencial dhe zbritje nga çmimet e shërbimeve nëpërmjet kartës së sigurimit. Në vijim, 8 paketat e ndryshme për Sigurimin e Jetës dhe Shëndetit Cash Plan që SiCRED ofron dhe mbulimet e përfitimet e tyre përkatëse:

OPSIONET E SIGURIMIT "JETË DHE SHËNDET CASH PLAN"	OPSIONI 1	OPSIONI 2	OPSIONI 3	OPSIONI 4	OPSIONI 5	OPSIONI 6	OPSIONI 7	OPSIONI 8
<b>Territori i Mbulimit:</b>								
Shqipëri	✓	✓	✓					
Europë (përfshirë Zvicër)				✓	✓	✓	✓	✓
Shuma Maksimale e Sigurimit	2,000 Euro	5,000 Euro	10,000 Euro	10,000 Euro	15,000 Euro	25,000 Euro	25,000 Euro	25,000 Euro
Përfitim për Sigurim Jete	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
<b>Mbulimet e Shëndetit:</b>								
Checkup Vjetor	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Vendi për kryerjen e Checkup	Shqipëri	Shqipëri	Shqipëri	Shqipëri	Shqipëri	Shqipëri	Itali Greqi	Austri
Mbulim të shpenzimeve mjekësore në rast sëmundje dhe aksidenti	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Përfitim për analiza, medikamente, vizita mjekësore, etj.	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Përfitim për ndërhyrje me shtrim	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Përfitim për ndërhyrje pa shtrim	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Kimioterapi dhe Radioterapi	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Sigurim i Shëndetit në Udhëtim (Europë):					✓	✓	✓	✓
Trajtim Urgjent					✓	✓	✓	✓
Evakuim/Riatdhesim					✓	✓	✓	✓

## Ecuria e SiCRED në pagesat e dëmeve në Tregun e Sigurimit të Jetës në 4-mujor:

Duke iu referuar 4-mujorit të parë të statistikave të Tregut të Sigurimit të Jetës nga AMF, SiCRED ka rritur prezencën e saj në pagesat e dëmeve, duke arritur një vlerë prej afërsisht 88 milion lekë, duke treguar kështu mbështetjen që ajo u ofron klientëve të saj. Ky rezultat i referohet kryesisht përfitimit të klientëve nga maturimi i produktit Jeta me Kursim, i cili është një produkt financiar me elementë kursimi, ku klienti njëkohësisht siguron jetën dhe investon.

## Produktet e Sigurimit të Jetës të kombinuara me Elementë Kursimi, risi e re në tregun financiar Shqiptar dhe financat personale të Shqiptarëve dhe mundësi e re investimi në Lek, USD dhe Euro:

Një tjetër produkt që SiCRED rekomandon, është Sigurimi i Jetës (me Mbijetesë). Ky sigurim, është po ashtu një kombinim i shkëlqyer i sigurimit të jetës dhe investimit financiar. Jeta e personit që pajiset me këtë policë sigurimi, sigurohet për një shumë të caktuar (shuma e sigurimit). I siguruarit përfiton këtë shumë në maturim të policës së sigurimit. E në rast se ai humbet jetën gjatë periudhës së sigurimit, pasardhësit e tij përfitojnë këtë shumë sigurimi, duke patur një mbështetje financiare në rast të kësaj fatkeqësie.

Me blerjen e një police të Sigurimit të Jetës (me Mbijetesë) me prim vjetor mbi 1,000 Euro ose kundërvleftën e saj në USD apo

Lek, SiCRED i ofron të siguruarit, bonus, policë sigurimi "Jetë dhe Shëndet" për vete, e madje deri edhe për familjen e tij.

Sigurimi i shëndetit ofron ekzaminime vjetore FALAS në njërin nga shtetet: Shqipëri, Itali, Austri, Turqi, Greqi, etj. Gjithashtu, garanton mbulimin e shpenzimeve mjekësore për vizita, barna mjekësore, ndërhyrje kirurgjikale, etj.

## Mbështetje e mëtejshme nëpërmjet SiCRED Assistance

Por, edhe në mungesë të një produkti sigurimi, SiCRED ofron mbështetje nëpërmjet shoqërisë së asistencës, SiCRED Assistance, e cila ofron shërbimin e ndërmjetësimit shëndetësor në spitalet dhe klinikat më të mira në Europë. Nëpërmjet këtij shërbimi përfitohen zbritje nga çmimet zyrtare, lehtësi në komunikim si pasojë e sinergjisë së grupit, shmangen burokracitë dhe procedurat e rezervimeve të takimeve e konsultave, shmangen procedurat e organizimit të udhëtimit, vendqëndrimit, etj.

Për më tepër informacion lidhur me produktet dhe rrjetin mjekësor të SiCRED në Shqipëri dhe jashtë vendit, vizitoni zyrat e SiCRED në:

Rr. "Brigada VIII", Vila nr. 3/1, Tiranë

ose kontaktoni në:

Tel.: +355 4 22 37 549

Cel.: + 355 69 20 84 026

Fax: +355 4 22 37 530

e-mail: contact@sicred.com.al

website: www.sicred.com.al